

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 232 Prot.

Tiranë, më 31.032015

VENDIM Nr. 27, datë 26.03.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 4, të datës 26.03.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për "Rishikim të vendimit të KKA nr. 18, datë 18.02.2015, të paraqitur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, për projekt-idenë e rrugës hyrëse, që do të lidhë By-passin "Fier-Levan" me Parkun Arkeologjik të Apolonisë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë kërkesën për rishikim të vendimit të KKA nr. 18, datë 18.02.2015, paraqitur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për projekt-idenë e rrugës hyrëse, që do të lidhë By-passin "Fier-Levan" me Parkun Arkeologjik të Apolonisë.
- II. ARRSH të depozitojë pranë ASHA projekt zbatimin e rrugës hyrëse, që do të lidhë By-Passin "Fier-Levan" me Parkun Arkeologjik të Apolonisë (variantin nr. 1), që kalon nga rruga ekzistuese e fshatit Sopë dhe pjesërisht ndërtohet e re.
- III. Të kryhen për segmentin e rrugës së re, sondazhe arkeologjike nga një subjekt i licencuar, duke lidhur aktmarrëveshje tre palëshe ndërmjet ARRSH, subjektit të licensuar dhe ASHA, sipas legjislacionit në fuqi, raporti i të cilave të paraqitet në KKA e rradhës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO